




RAPORT FINANCAT PUBLIKE VENDORE Janar – Qershor 2018

www.financatvendore.al



CO-PLAN, INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E HABITATIT

SHTATOR 2018



PËRBAJTJE

1. Hyrje	3
2. Burimet financiare	4
2.1 Burime financiare të pakushtëzuara	6
2.1.1 Të ardhura nga burime të veta:.....	6
2.1.2 Të ardhura nga taksat e ndara.....	11
2.1.3 Transferta ndërqeveritare të pakushtëzuara	12
2.2 Burime financiare të kushtëzuara	13
2.3 Burime financiare sipas bashkive	13
3. Shpenzimet	15
3.1 Shpenzime sipas klasifikimit ekonomik.....	15
3.2 Shpenzime sipas klasifikimit funksional	19
4. Përfundime.....	21

Listë tabelash

Tabelë 1. Burime financiare sipas kategorive (në lekë)	5
Tabelë 2. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive(në lekë).....	10
Tabelë 3. Të ardhura nga tarifat për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave.....	11
Tabelë 4. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike (6M2018, në lekë).....	16

Listë grafikësh

Grafik 1. Burimet financiare	4
Grafik 2. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në pikë përqindje)	5
Grafik 3. Burime financiare të pakushtëzuara (bm) dhe ndryshime vjetore (bd)	6
Grafik 4. Të ardhura nga burime të veta vendore	7
Grafik 5. Të ardhura nga taksa vendore	7
Grafik 6. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%)	8
Grafik 7. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme.....	9
Grafik 8. Të ardhura nga tarifat vendore	10
Grafik 9. Të ardhura nga taksat e ndara	11
Grafik 10. Transferta e pakushtëzuar dhe specifike.....	12
Grafik 11. Transferta e kushtëzuar	13
Grafik 12. Burimet financiare sipas bashkive	14
Grafik 13. Tregues për të ardhurat dhe shpenzimet vendore 2018H1 (nd. vjetore).....	15
Grafik 14. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike (6M2018).....	16
Grafik 15. Shpenzimet operative sipas zërave	17
Grafik 16. Shpenzimet kapitale.....	18
Grafik 17. Shpenzimet kapitale.....	18
Grafik 18. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike për 61 bashki.....	19
Grafik 19. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional.....	20

1.

HYRJE

Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në financat publike vendore është një hap i rëndësishëm në vlerësimin e kapacitetit financiar të tyre në funksion të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjithashtu, një kuptim më i mirë i raportit kompetenca – burime financiare të disponueshme informon hartimin e politikave efektive dhe eficiente në qeverisjen vendore, lehtëson dialogun ndërmjet niveleve të qeverisjes, informon mbi kapacitetet huamarrëse, përmirëson llogaridhënien, transparencën dhe besimin e komunitetit në përfaqësuesit vendorë.

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë një analizë të përgjithshme të performancës, prirjeve dhe situatës financiare të 61 bashkive të reja në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018. Të dhënat janë kumulative ose stok në fund të periudhës dhe janë të shprehura në monedhë vendase (lekë). Nga pikëpamja metodologjike, krahasimi vjetor me të dhënat faktike të viteve të mëparshëm bëhet duke iu referuar të dhënave në nivel 373 njësi të qeverisjes vendore (ish-bashki dhe ish-komuna) të cilat më tej u konsoliduan në 61 bashki (ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”). Në këtë kuadër, raporti analizon shkurtimisht burimet e financimit të bashkive, koston e qeverisjes vendore dhe mënyrën e përdorimit të burimeve financiare publike në nivel vendor.

Ky raport është pjesë e një serie raportesh me frekuencë tremujore dhe vjetore për financat vendore të përgatitur nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Burimi i të dhënave financiare për njësitë e qeverisjes vendore të nivelit të parë (bashkitë) është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë përpunuar dhe më pas publikuar në platformën www.financatvendore.al.¹

Raportet e mëparshme mund të gjenden në: <http://www.financatvendore.al/pub/raporte>.

Për një panoramë të përgjithshme për secilën prej 61 bashkive, mund të konsultoni Profilët e Bashkive në: <http://www.financatvendore.al/analiza/profilet>.


¹Ky raport paraprihet nga raporti për tremujorin e parë të vitit 2018. Raportet dhe materiale të tjera mbi qeverisjen vendore mund të gjenden në platformën www.financatvendore.al. Në këtë platformë ju mund të ndërtoni vetë raportin tuaj për të monitoruar nga burojnë të ardhurat vendore dhe si shpenzohen ato nga bashkia juaj. Gjithashtu do të mund të gjeni edhe dokumente me interes si buxhetet dhe paketat fiskale të bashkisë tuaj.

2.

BURIMET FINANCIARE

Ky seksion synon të pasqyrojë nga burojnë fondet me të cilat bashkitë ushtrojnë funksionet, përgjegjësitë dhe ofrojnë shërbime për komunitetin përkatës si dhe performancën e tyre në periudhën janar – qershor 2018 (të dhëna progresive).² Burimet financiare totale në dispozicion të qeverisjes vendore regjistruan një vlerë **35.4 miliard lekë**³ në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, në rënie me rreth 7.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nëse nga totali i burimeve financiare do të përjashtonin ato kategori të konsideruara me destinacion (transferta të kushtëzuara), të ardhurat mbi të cilat bashkitë ushtrojnë autoritet dhe kanë të drejta vendimmarrje shënuan një vlerë prej rreth **21.5 miliard lekë**.

Grafik 1. Burimet financiare



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Përjashtuar të hyrat nga transfertat e kushtëzuara, të ardhurat në dispozicion të bashkive në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, përfaqësuan rreth 60.7% të burimeve financiare totale dhe përfshijnë: të ardhurat nga burimet e veta, të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike⁴ dhe të ardhurat nga taksa të ndara.

² Burimet financiare totale të njëjësive të vetëqeverisjes vendore përfshijnë: (i) të ardhurat nga burime të veta vendore (taksa, tarifa, të tjera dhe huamarrje), (ii) të ardhura nga transfertat ndërqeveritare ku përfshihen të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike, (iii) të ardhurat nga taksat e ndara, dhe (iv) të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara.

³ Kjo shifër nuk përfshin të ardhurat nga fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm (të kushtëzuara apo jo). Ndërkohë, përfshihen të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku ndër burimet e financimit të bashkive përfshihet edhe kjo kategori.

⁴ Transferta specifike deri më tani trajtohet si transfertë e kushtëzuar, por në vijim parashikohet të jetë pjesë e transfertës së pakushtëzuar (pasi të kalojë faza tranzitore e transferimit të funksioneve të reja).

Në strukturën e burimeve financiare, transfertat e kushtëzuara nga ministritë e linjës, përfaqësojnë rreth 39.3% ndaj totalit, rreth 4.8 pikë përqindje nën mesataren afatgjatë (llogaritur si mesatare e peshës së kësaj kategorie ndaj totalit për periudhat e referuara). Të hyrat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike vijojnë të zënë peshë të rëndësishme në buxhetet vendore. Kjo kategori të hyrash përfaqësoi rreth 33.5% të burimeve financiare totale. Ndërkohë, të ardhurat nga burimet e veta rezultojnë të kenë ulur peshën e tyre ndaj totalit në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 në rreth 25.4% nga rreth 30.4% që ishte një vit më parë.


Tabelë 1. Burime financiare sipas kategorive (në lekë)

	Të ardhura nga burime të veta	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Taksa të ndara	Transferta të kushtëzuara	Burime financiare totale
6M 2010	6,785,867,150	6,818,561,280	285,724,830	10,438,172,320	24,328,325,580
6M 2011	6,947,663,510	10,520,319,000	346,111,300	11,336,899,730	29,150,993,540
6M 2012	6,788,317,410	5,744,859,000	569,888,060	11,718,117,650	24,821,182,120
6M 2013	5,674,008,200	6,003,367,390	676,276,250	14,348,432,320	26,702,084,160
6M 2014	6,650,153,140	6,607,503,290	438,209,110	12,891,038,380	26,586,903,920
6M 2015	7,279,768,080	5,601,599,770	523,135,140	12,622,270,640	26,026,773,630
6M 2016	8,783,434,200	9,927,593,660	440,673,390	10,686,371,320	29,838,072,570
6M 2017	11,457,332,430	12,268,562,510	594,941,670	13,999,961,150	38,320,797,760
6M 2018	8,997,507,630	11,869,550,126	638,188,027	13,896,717,989	35,401,963,771

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ngushtimi i burimeve financiare totale u përcaktua gjerësisht prej ecurisë së të hyrave nga burime të veta vendore, të cilat kontribuan me rreth 6.4 pikë përqindje në rënien vjetore të burimeve financiare. Në të njëjtin drejtim edhe pse në masë më të vogël, kontribuoi edhe ecuria e transfertës pakushtëzuar dhe specifike. Kontributi i lehtë pozitiv i të ardhurve nga taksat e ndara nuk arriti të kundërbalancojë efektin ngushtues të dy kategorive të lartpërmendura.

Grafik 2. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në pikë përqindje)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.1

BURIME FINANCIARE TË PAKUSHTËZUARA

Burimet financiare të pakushtëzuara⁵ regjistruan një nivel prej rreth 21.5 miliard lekë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, në rënie me rreth 12.6% në terma vjetorë. Ngushtimi në të hyrat vjetore të pakushtëzuara u përcaktua në masë të madhe rënia në të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa, tarifa dhe të tjera). Të hyrat nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike gjithashtu kontribuan negativisht, por në masë më të ulët. Në të kundërt, të hyrat nga taksat e ndara, ndonëse me një peshë modeste, kontribuan pozitivisht në totalin e burimeve të financiare të pakushtëzuara në fund të gjashtëmujorit të parë 2018.

Grafik 3. Burime financiare të pakushtëzuara (bm) dhe ndryshime vjetore (bd)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.1.1


TË ARDHURA NGA BURIME TË VETA: Taksa, tarifa dhe burime të tjera vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asetet dhe të tjera) regjistruan në terma nominalë rreth 9.0 miliard lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të hyrat buxhetore nga burimet e veta rezultojnë rreth 2.5 miliard lekë më të ulëta ose në rënie me rreth 21.5%. Kjo ecuri e të ardhurave të veta përgjatë periudhës

⁵ Llogaritur konvencionalisht si shumë e (i) të ardhura nga burime të veta vendore (taksa, tarifa, të tjera dhe huamarrje), (ii) të ardhura nga transfertat ndërqeveritare ku përfshihen të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike, (iii) të ardhurat nga taksat e ndara

së marrë në analizë u kushtëzua nga performanca relativisht e ulët e të ardhurave nga *taksat vendore*, të cilat regjistruan një nivel prej rreth 4.7 miliard lekë, në ulje me rreth 38.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të kundërt, të ardhurat nga tarifat vendore ndoqën ecuri pozitive.


Grafik 4. Të ardhura nga burime të veta vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ngushtimi i të ardhurave nga taksat vendore u përcaktua gjerësisht nga rënia e të hyrave nga *taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksa mbi pasuritë e paluajtshme*. Të hyrat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, pas një rritje të theksuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, u tkurrën me rreth 53.4% në terma vjetorë dhe regjistruan rreth 1.4 miliard lekë.


Grafik 5. Të ardhura nga taksa vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, rënia e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë u udhëhoq nga bashkia Tiranë. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një nivel prej rreth 657.1 milionë lekë nga rreth 2.1 miliard lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të kundërt, bashkia Vlorë rezulton të ketë mbledhur rreth 84 milionë lekë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, nga një nivel zero në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në bashkitë Vorë dhe Durrës, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë rezultojnë të jenë thuajse përgjysmuar krahasuar me nivelin e shënuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017.

Grafik 6. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Një tjetër burim i rëndësishëm të ardhurash për buxhetin vendor përfaqësohet nga të ardhurat nga *taksa mbi pasuritë e paluajtshme*. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një vlerë prej rreth 1.7 miliardë lekë, në rënie me rreth 36.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Tkurrrja e të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme u përcaktua nga rënia me rreth 42.6% në terma vjetorë e të ardhurave nga *taksa e ndërtesës*.

Performanca e dobët e regjistruar në të hyrat nga taksa e ndërtesës bie ndesh me pritshmëritë e krijuara në vijim të reformimit rrënjësor të kësaj takse nëpërmjet ligjit nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar". Larg nga çfarë synuar, vështirësitë në krijimin e kadastrës fiskale, përcaktimit të vlerës së pronës sipas vendndodhjes, përcaktimi i një agjenti tatimor etj., vlerësohet të kenë krijuar paqartësi të shtuara për bashkitë, të cilat mund të kenë kontribuar në performancën e kësaj takse gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Njëkohësisht, një pjesë e bashkive kanë vijuar të aplikojnë taksën e ndërtesës sipas metodologjisë së vjetër, deri në përfundim të periudhës tranzitore për të akomoduar metodologjinë e re me bazë vlerën. Fillim viti 2019 pritet të jetë dhe momenti kur të gjitha bashkitë në vend do të aplikojnë taksën e pronës sipas metodologjisë së re, bazuar në komunikimet në media të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.⁶

⁶ <http://www.financa.gov.al/nuk-ka-shtyrje-te-aplikimit-te-taksese-se-prones-procesi-ka-filluar-dhe-po-vazhdon/>

Megjithatë, mbetet për tu vlerësuar nëse kemi të bëjmë me vështirësi të përkohshme në zbatimin e metodologjisë së re në lidhje me aplikim e kësaj takse apo me vështirësi strukturore të cilat shkojnë përtej kompetencave të bashkive.

Grafik 7. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga *taksa mbi tokën bujqësore* rezultojnë të kenë kontribuar me rreth 307.8 milionë lekë në të ardhurat vendore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, në rritje me rreth 26.3% në terma vjetorë. Në të kundërt, *taksa e truallit* vijon të rezultojë pa të ardhura të regjistruara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, ashtu sikurse evidentohet dhe në të gjitha periudhat e tjera të marra në shqyrtim. Kjo mund të lidhet me problematikat e mungesës pothuajse totale të regjistrave të bazës së taksës (dhe taksapaguesve). Gjithashtu mund të jemi përballë edhe të një problemi të raportimit financiar, dhe një vlerësim më i thellë do duhej të bëhej nga autoritetet.

Të ardhurat nga *tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël* regjistruan një vlerë prej 271.5 milionë lekë, me një rritje prej 14.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2017. Në terma afatgjatë dhe në vijim të ndryshimeve të ndërmarra, të ardhurat nga kjo taksë vijnë të ulin në mënyrë progresive kontributin e tyre në totalin e të ardhurave nga burime të veta vendore.

Në ndryshim nga ecuria e të ardhurave nga taksat vendore, të ardhurat nga *tarifat vendore* rezultojnë të jenë rritur në gjysmën e parë të vitit 2018 përkundërt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në terma nominalë, tarifat vendore kontribuan në të ardhurat vendore me rreth 4.2 miliard lekë, në rritje me rreth 5.4% në terma vjetorë.

Grafik 8. Të ardhura nga tarifat vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Peshën më të madhe në tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat e shërbimeve. Kështu, të ardhurat nga *tarifat e shërbimeve publike* rezultuan në rreth 1.9 miliard lekë, në ulje me rreth 16.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Në këtë kategori, të ardhurat e gjenenuara nga tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve përfaqësuan rreth 83.5% ndaj totalit, ndjekur nga tarifa për ndriçimin publik me rreth 9.2% dhe tarifa për gjelbërimin me rreth 7.2%. Ndërkohë, të ardhurat nga tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet regjistrojnë një vlerë tepër të ulët e cila rezultoi të mbledhur vetëm nga bashkitë Ura Vajgurore dhe Krujë. Kjo për vetë faktin se të ardhurat nga kjo tarifë mbledhen thuajse ekskluzivisht nga ndërmarrjet e ujësjellës - kanalizime (të cilat janë në pronësi të bashkive) duke mos u regjistruar kështu në llogaritë e të ardhurave të bashkive. Gjithashtu, të ardhurat nga tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit regjistruan shifra relativisht modeste dhe janë grumbulluar nga bashkitë Elbasan, Roskovec dhe Lushnjë. Paraprakisht, mund të thuhet se ka marzhe përmirësimi të mbledhjes së kësaj tarife, sidomos në ato bashki ku toka bujqësore nën juridiksion ka nevojë për shërbime të ujitjes dhe kullimit.

Tabelë 2. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në lekë)

Të ardhura nga tarifat vendore totale	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	Tarifa për ndriçimin publik	Tarifa për gjelbërimin	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit
1,914,064,190	1,598,980,379	176,432,088	138,032,106	126,900	492,717

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ngjashëm me kategoritë e analizuar më sipër, *të ardhurat nga tarifat administrative dhe të tjera* rezultuan me rritje prej rreth 13.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tarifa për *zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave* gjithashtu ka pësuar një rritje të konsiderueshme në periudhën në analizë duke shënuar një vlerë prej 707.4 milionë lekë nga 292.7

milione lekë të mbledhura në të njëjtën periudhë të vitit 2017. Nëse do të shikonim performancën e zërave specifike, rezulton se të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi zë peshën më të lartë me rreth 48.3% të totalit, ndjekur nga të ardhurat nga tarifa për parkingjet (40.8%) dhe tarifa e reklamave (11%). Lidhur me të ardhurat nga tarifa për parkingjet, vlen për t'u përmendur fakti se vetëm bashkia Tiranë mbledh rreth 80.7% të të ardhurave totale nga kjo tarifë. Në këtë drejtim, bashkitë e tjera të mëdha, qendër qarku, nuk kanë patur të njëjtën performancë, ndonëse kanë potencial (duke konsideruar numrin e popullsisë dhe të automjeteve).

Tabelë 3. Të ardhura nga tarifat për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave (6M2018)

Të ardhura nga tarifat për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike (në lekë)	Tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi (në lekë)	Tarifa për reklamën (në lekë)	Tarifa për parkingjet (në lekë)
707,408,527	341,522,055	77,505,956	288,380,516


Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.1.2

TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Me miratimin e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", u rishikuan dhe shtuan kategoritë e taksave të ndara ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Kështu, bashkitë përfitojnë: (i) 97% e të ardhurave nga taksat e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, persona fizikë dhe juridikë; (ii) 25% të të ardhurave nga taksat vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; (iii) 5% të të ardhurave nga renta minerare; dhe (iv) 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Grafik 9. Të ardhura nga taksat e ndara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në tërësi, të ardhurat nga taksat e ndara kontribuan në buxhetin vendor me rreth 638.2 milionë lekë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, në rritje me rreth 7.3% në terma vjetorë. Ndonëse me miratimin

e ligjit të ri për financat vendore pritej që kjo kategori të hyrash të rriste kontributin në burimet financiare të bashkive (veçanërisht, nga 2% e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale), efektet e tij ende nuk duket të jenë materializuar.


2.1.3

TRANSFERTA NDËRQEVERITARE TË PAKUSHTËZUARA⁷

Transferta e pakushtëzuar dhe specifike

Të hyrat nga transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike janë një burim i rëndësishëm për financimin e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave nga bashkitë. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sanksionoi përmasën dhe mënyrën e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar: për çdo vit buxhetor, ajo është jo më pak se 1 % e PBB-së sipas parashikimeve dhe vlerësimeve makroekonomike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe në çdo rast, nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm; ndarja e saj bëhet nëpërmjet formulës së miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Grafik 10. Transferta e pakushtëzuar dhe specifike



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Praktikisht, prirja e të hyrave nga transferta e pakushtëzuar është paracaktuar ligjërisht. Deri në fund të qershorit të vitit 2018, rezultojnë të jenë arkëtuar rreth 11.9 miliard lekë nga transferta e pakushtëzuar (bashkë me transfertën specifike), rreth 3.3% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rënie mund të jetë përcaktuar nga fazimi në kohë i disbursimeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.


⁷ Ndonëse transferta specifike deri më tani sillet si një transfertë e kushtëzuar, me destinacion, është e pamundur teknikisht të ndahet. Megjithatë, nisur nga sa parashikuar në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 23, "shuma totale e transfertës së pakushtëzuar, pas përfundimit të periudhës tranzitore të transferimit të funksioneve të reja në nivel vendor, rritet me madhësinë e transfertave specifike që vendoset të përfshihen brenda transfertës së pakushtëzuar" mund ti konsiderojmë së-bashku.

2.2

BURIME FINANCIARE TË KUSHTËZUARA

Ndonëse nuk ushtrojnë kontroll mbi destinacionin e tyre, të hyrat nga transfertat e kushtëzuara⁸ përfaqësuan rreth 39.3% ndaj totalit të burimeve financiare të bashkive në gjysmën e parë të vitit 2018. Gjatë periudhës në analizë, qeveria qendrore u transferoi bashkive rreth 13.9 miliard lekë në trajtën e transfertës së kushtëzuar, në ulje me rreth 0.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Sipas ministrive të linjës, rreth 8.5 miliard lekë u transferuan nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale. Rreth 5.4 miliard lekë u alokuan nga ana e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë; për arsimin, sportin dhe rininë; zhvillimi urban (Fondi i Zhvillimit Rajonal) etj..

Grafik 11. Transferta e kushtëzuar



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.3


BURIMET FINANCIARE SIPAS BASHKIVE

Struktura e burimeve të financimit për bashkitë mund të përdoret si një tregues i tërthortë për të vlerësuar kapacitetin financiar të tyre, mundësinë për të ndërmarrë investime në mënyrë të pavarur dhe për të përmbushur kërkesat e komunitetit për shërbime publike. Mesatarisht për 61 bashkitë në vend, të ardhurat nga burimet e veta përfaqësuan rreth 25.4% ndaj burimeve totale, të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike rreth 33.5% dhe të ardhurat nga taksat e ndara rreth 1.8% ndaj burimeve të financimit totale në fund të gjysmës së parë të vitit 2018. Historikisht, transfertat e kushtëzuara kanë

⁸ Për t'u theksuar se në këtë kategori të ardhurash, bashkitë nuk kanë autoritet vendim-marrje. Këto fonde shpenzohen sipas destinacionit të përcaktuar nga entiteti qendror. Psh. transfertat e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, mund të shpenzohet vetëm për këtë qëllim, pra bashkitë nuk mund tua ndryshojnë destinacionin.

përfaqësuar nivelin më të lartë të të hyrave në buxhetet vendore dhe në periudhën e konsideruar ato u vlerësuan në rreth 39.3% ndaj totalit të burimeve financiare. Një panoramë e përgjithshme mbi burimet e financimit të bashkive vijon të evidentojë diferenca theksuara ndërmjet tyre edhe bazuar në të dhënat për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018.

Grafik 12. Burimet financiare sipas bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, pesha që zënë të ardhurat e veta (taksa, tarifa dhe të tjera) në totalin e burimeve të financimit luhet në një interval të gjerë vlerash: vlera minimale u regjistrua në bashkinë Has me 1.8% dhe vlera maksimale në bashkinë Tiranë me rreth 78.1%. Në përpjesëtim të zhdrejtë, aty ku të ardhurat nga burimet vendore janë të ulëta, të ardhurat nga transfera e pakushtëzuar dhe specifike financojnë gjerësisht buxhetin e bashkisë.


3.

SHPENZIME

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Analiza e shpenzimeve tenton të ofrojë një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën si janë shpenzuar paratë në dispozicion të bashkive: sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime), sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike, mbrojtje mjedisi etj.).

Në total, shpenzimet e kryera nga bashkitë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 regjistruan një vlerë prej rreth **39.7 miliard lekë**, shifër kjo rreth 5.2% më e lartë se ajo e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të shkuar. Përfundimisht shpenzimet e kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm, rezultojnë se bashkitë kanë alokuar në gjysmën e parë të vitit rreth **34.3 miliard lekë**, rreth 4.0% më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 13. Tregues për të ardhurat dhe shpenzimet vendore (ndryshime vjetore)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.1

SHPENZIME SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, zgjerimi i shpenzimeve publike vendore me rreth 5.2% u përcaktua nga të dyja kategoritë: shpenzimet korrente dhe ato kapitale. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente regjistruan një nivel prej rreth 26.6 miliard lekë, në rritje me rreth 4.6% në terma vjetorë. Të

njëjtën ecuri ndoqën dhe shpenzimet kapitale, të cilat regjistruan një vlerë prej rreth 13.2 miliard lekë, në rritje me rreth 6.2% krahasuar me vitin e mëparshëm.


Tabelë 4. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike (6M2018, në lekë)

	SHPENZIME KORRENTE (1)					SHPENZIME KAPITALE (2)	SHPENZIME TOTALE (1) + (2)
	Shpenzime personeli	Operative	Subvencione	Transferta	Interesa		
6M2010	4,884,888,430	4,139,129,370	263,481,160	8,076,919,350	39,165,110	6,495,325,020	23,898,908,440
6M2011	5,152,473,510	4,306,327,230	700,403,890	8,056,491,970	13,566,070	7,029,290,010	25,258,552,680
6M2012	5,070,495,300	4,455,006,610	254,969,680	9,501,704,760	19,087,330	4,949,642,040	24,250,905,720
6M2013	5,325,886,470	4,521,140,560	354,597,190	11,615,125,100	17,735,270	7,091,190,060	28,925,674,650
6M2014	5,469,891,200	4,029,512,890	167,633,410	11,631,698,970	12,431,340	3,126,060,410	24,437,228,220
6M2015	5,487,221,150	4,450,069,890	236,965,550	10,402,726,920	27,526,450	7,741,596,020	28,346,105,980
6M2016	7,570,077,180	4,354,282,660	141,379,330	9,400,821,060	23,886,800	4,325,001,690	25,815,448,720
6M2017	9,438,576,480	5,497,095,410	337,888,450	10,075,499,870	22,546,210	12,424,615,220	37,796,221,640
6M2018	10,467,989,260	7,026,733,640	65,801,091	8,905,118,752	84,954,461	13,198,228,619	39,748,825,823

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndër përbërësit e shpenzimeve korrente, shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime) përbënë rreth 10.5 miliard lekë gjatë periudhës së konsideruar, në rritje me rreth 10.9% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2017. Shpenzimet për personelin vijnë të ndjekin prirje rritëse vjetore, ndonëse me ritme më të moderuara ndikuar dhe nga shuarja e efektit të rritjes së numrit të punonjësve si pasojë e transferimit të funksioneve të reja⁹.

Grafik 14. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike (6M2018)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

⁹ Shpenzimet e personelit për funksionet e reja mbulohen me fonde nga transferta specifike. Nëse bashkëtë duan të performojnë më mirë apo të rritin cilësinë e këtyre shërbimeve, kostot mbulohen me burime të tjera të pakushtëzuara.

Shpenzimet operative dhe të tjera regjistruan një nivel prej rreth 16.1 miliard lekë në fund të gjashtë muajve të parë të vitit 2018, me një rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë. Në nivel të detajuar, shpenzimet operative për këtë periudhë shënuan një vlerë prej rreth 7.0 miliard lekë, në rritje me rreth 27.8% në terma vjetorë. Në rritje të theksuar rezultojnë shpenzimet për materiale zyre (+58.6%); shërbime nga të tretë (+23.6%); shpenzimet të tjera operative (+40.5%); mirëmbajtje e zakonshme (+26.8%). Në periudhën në analizë, shpenzimet për udhëtime rezultojnë të jenë tkurrur me 16.6% në terma vjetorë. Ndër të gjitha periudhat e konsideruara, ecuria e shpenzimeve operative qartësisht po ndjek një trajektore rritëse veçanërisht në tre vitet e fundit, ku gjashtëmujori i parë i vitit 2018 shënoi nivelin maksimal të tyre. Ndonëse, rritja e shpenzimeve në këtë kategori rezulton të jetë e shpërndarë në thuajse të gjithë nën-zërat përbërës, ecuria e tyre duhet monitoruar në kohë dhe vlerësuar nëse është një efekt i përkohshëm apo strukturor.

Grafik 15. Shpenzimet operative sipas zërave




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet për *transferta për buxhetet familjare dhe individët* gjithashtu janë një zë i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve vendore. Në tre vitet e fundit, pesha e kësaj kategorie në totalin e shpenzimeve është tkurrur nga rreth 47.6% në vitin 2014 në një nivel prej 22.4% në vitin 2018. Gjatë periudhës së konsideruar, kjo kategori shpenzimesh shënoi një vlerë prej rreth 8.9 miliard lekë, në rënie me rreth 11.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në pjesën më të madhe, këto fonde burojnë nga ministria përgjegjëse për funksionin e mbrojtjes sociale në trajtën e transfertës së kushtëzuar për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Shpenzimet kapitale ose investimet, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxheteve vendore dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor afatgjatë. Ndër vite, niveli i shpenzimeve kapitale ka qenë i luhatshëm edhe pse paraqet një korrelacion të mirë me ecurinë e burimeve financiare të veta të bashkisë. Shpesh, kjo luhatshmëri është ndikuar dhe përcaktuar nga transfertat e kushtëzuara nga ministrinë e linjës dhe/ose Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Gjithashtu, në fazimin në kohë të shpenzimeve kapitale ndikon edhe ecuria në zbatimin e planit të prokurimeve për mallra, shërbime apo punë publike nga bashkitë. Pas rritjes së përshpejtuar në gjysmën e parë të vitit 2017, shpenzimet për investime

shënuan një vlerë prej rreth 13.2 miliard lekë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, në rritje me rreth 6.2% në terma vjetorë. Sipas burimit të financimit, investimet publike vendore rezultojnë të jetë financuar kryesisht nga burimet e veta të bashkive për rreth 8.1 miliard lekë, ndërkohë që qeverisja qendrore ka financuar rreth 5.1 miliard lekë.


Grafik 16. Shpenzimet kapitale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Sipas funksioneve të qeverisjes, shpenzimet kapitale për funksionet “çështjet ekonomike” (ku përfshihet infrastruktura e transportit) dhe “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” (ku përfshihen shpenzimet për strehimin dhe urbanistikë, ujësjellës dhe kanalizime vendore, ndriçimi publik) zënë peshën kryesore të shpenzimeve kapitale në të gjitha periudhat e marra në analizë. Gjatë këtij gjashtëmujori, rezulton se investimet për funksionin “çështjet ekonomike” shënuan rënie me rreth 33% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Grafik 17. Shpenzimet kapitale




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndërkohë, investimet në funksionin “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 67.6% në terma vjetorë. Me transferimin e kompetencave të reja në lidhje me arsimin parashkollor dhe atë para-universitar, bashkitë kanë rritur nivelin e investimeve në infrastrukturën arsimore. Përkatësisht, investimet në arsim në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 regjistruan një nivel prej rreth 1.2 miliard lekë, në rritje me rreth 47.4% në terma vjetorë.

Ndonëse në terma të përgjithshëm shpenzimet kapitale rezultojnë të jenë rritur, shtrirja e tyre në nivel bashkie nuk ka qenë e njëtrajtshme. Për të treja kategoritë e shpenzimeve, bashkitë paraqesin diferenca të forta ndërmjet tyre. Bashkia Libohovë rezulton të ketë dedikuar rreth 73.9% të buxhetit të saj vjetor për shpenzime kapitale (niveli maksimal i regjistruar).¹⁰ Në të kundërt, bashkia Lezhë rezulton të ketë shpenzuar rreth 2.9% të buxhetit të saj për investime publike vendore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 (niveli minimal i regjistruar).

Grafik 18. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike për 61 bashki (total = 100%)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2


SHPENZIME SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL

Në klasifikimin e shpenzimeve bazuar në funksionet e qeverisjes (klasifikimi COFOG), rezulton se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, rreth 27.3% e burimeve financiare ose rreth 10.8 miliard lekë u shpenzuan në funksionin “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” (+37.9% në terma vjetorë). Brenda këtij funksioni, rreth 9.2 miliard lekë u alokuan në nën-funksionin e zhvillimit të komunitetit (+36.9% krahasuar me një vit më parë) i cili përmban veprimtari që synojnë përmirësimin e kontekstit të jetesës si përmirësimin e hapësirave të përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin, përmirësimi i hapësirave të gjelbërta, mirëmbajtjen e trotuareve, parqeve, lulishteve etj. Diferenca prej rreth 1.5 miliard lekë u shpenzua në nën-funksionet e strehimit, urbanistikës vendore dhe furnizimit me ujë.

¹⁰ Ky rezultat diktohet nga përmasat shumë të vogla të buxhetit të bashkisë Libohovë.

Funksioni i “mbrojtjes sociale” përbëhet rreth 24.6% të shpenzimeve totale apo rreth 9.7 miliard lekë (kryesisht këto janë fonde të kushtëzuara të transferuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale). Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet në këtë funksion rezultojnë të jenë tkurrur me rreth 16.3% në terma vjetorë.

Grafik 19. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet në funksionin “çështjet ekonomike”, ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit rrugor, rezultojnë të jenë tkurrur me rreth 1.7 miliard lekë në periudhën e konsideruar, ose në rënie me rreth 22.0% në terma vjetorë.

Rritje me rreth 16.3% në terma vjetorë shënuan shpenzimet e dedikuara për funksionin e “arsimit”, rritje e cila vlerësohet të jetë pasojë e funksioneve të reja të transferuara nga qeverisja qendrore drejt asaj vendore (për pagat e personelit mësimdhënës dhe mbështetës në kopshte dhe çerdhe, dhe personelit mbështetës në arsimin fillor dhe të mesëm).

4.

PËRFUNDIME

Performanca e bashkive në kahun e burimeve financiare të disponueshme vlerësohet relativisht e dobët në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018. Në total, burimet financiare në dispozicion shënuan një nivel prej rreth 35.4 miliard lekë, në rënie me rreth 7.6% në terma vjetorë. Kjo performancë është diktuar gjerësisht prej ecurisë së të ardhurave nga burimet e veta vendore, mbledhja e të cilave vijon të mbetet ende larg potencialeve që ato paraqesin si pasojë e problemeve strukturore në administrimin e tyre. Varësia e buxheteve vendore nga një numër i kufizuar taksash pasqyroj njëkohësisht dhe dobësinë e tyre, materializuar në rënien e të ardhurave me rreth 21.5% në terma vjetorë, diktuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Për nga natyra, kjo taksë është ngushtësisht e lidhur me presionin zhvillimor dhe paraqet parashikueshmëri të ulët. Krahas taksës së ndikimit në infrastrukturë, të ardhurat nga taksat e pronës (taksa e ndërtesës) gjithashtu rezultojnë të jenë në rënie në periudhën e konsideruar. Performanca e dobët e regjistruar në të hyrat nga taksa e ndërtesës bie ndesh me pritshmëritë e krijuara në vijim të reformimit rrënjësor të kësaj takse nëpërmjet ligjit nr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”. Larg nga çfarë synuar, vështirësitë në krijimin e kadastrës fiskale, përcaktimit të vlerës së pronës sipas vendndodhjes, përcaktimi i një agjenti tatimor etj., vlerësohet të kenë krijuar paqartësi të shtuara për bashkitë, të cilat mund të kenë kontribuar në performancën e kësaj takse gjatë gjysmës së parë të vitit 2018.

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Në gjysmën e parë të vitit 2018, bashkitë kryen shpenzime për rreth 39.7 miliard lekë, në rritje me rreth 5.2% në terma vjetorë (përfshirë shpenzimet me fonde të kushtëzuara). Zgjerimi i shpenzimeve publike vendore vijon të përcaktohet gjerësisht nga ecuria e shpenzimeve korrente (veçanërisht shpenzimeve për personelin dhe atyre operative). Kjo ecuri nuk përputhet me eficiencën operacionale të synuar nga reforma administrative dhe territoriale. Ndërkohë, shpenzimet kapitale vijnë të ndjekin prirje rritëse. Bashkitë investuan rreth 13.2 miliard lekë në gjysmën e parë të vitit 2018, në rritje me rreth 6.2% në terma vjetorë. Strehimi dhe zhvillimi i komunitetit, infrastruktura rrugore, ujësjellës – kanalizimet dhe arsimit, duket të jenë funksionet që përthithën pjesën më të madhe të investimeve publike vendore.